REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7935 Nr. i faq/Br.str/No.pg 96
Data/Datum/Date 07/10/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit

LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

MUAJI SHTATOR 2026

Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1.	Vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës.	NRP-02-7832-2026
2.	Vendim për ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore.	NRP-02-7840-2026
3.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave-Rinovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve.	NRP-02-7841-2026
4.	Vendim për lirimin nga pozita e emërimit të përkohshëm të drejtorit të ShFMU "Isa Bloetini" në Rahovec.	NRP-02-7842-2026
5.	Vendim për për Autorizimin e ushtrimit të pozitës së drejtoreshës së ShFMU "Isa Boiletini" në Rahovec.	NRP-02-7847-2026
6.	Vendim për për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: " Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkolla"	NRP-02-7848-2026
7.	Vendim për transferimin e përhershëm të nënpunësit të shërbimit publik.	NRP-02-7852-2026
8.	Vendim për gjeni vendimin për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-7854-2026
9.	Vendim për për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: *"Shitja e aseteve jashtë funksioni"*	NRP-02-7861-2026
10.	Vendim për për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: *"Shitja e aseteve jashtë funksionit"*	NRP-02-7862-2026
11.	Vendim për për shfuqizimin e urdhëresës për shpalljen e tenderit: *"Servisimi i paisjeve mjekësore"*	NRP-02-7865-2026
12.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: *"Furnizim me paisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së"*	NRP-02-7867-2026
13.	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë.	NRP-02-7873-2026
14.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: *"Rinovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve".*	NRP-02-7876-2026
15.	Vendim për miratimin e kërkesës për inicimin dhe zhvillimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit.	NRP-02-7877-2026
16.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e automjetit (kombi).	NRP-02-7878-2026
17.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës: *"Furnizimi me rekuizita për nevojat e komunës së Rahovecit"*	NRP-02-7879-2026

18.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : *"Restaurimi dhe digjitalizimi i muzeve dhe objekteve përkujtimore"*	NRP-02-7882-2026
19.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike/termave të referencës për aktivitetin e prokurimit : *"Rinovimi i objektit të palestrës sportive Mizahir Isma"*	NRP-02-7883-2026
20.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve tekniketermave të referencës për aktivitetin e prokurimit : *"Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit"*	NRP-02-7885-2026
21.	Vendim për mbulimi i shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-7886-2026
22.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: *"Sinjalizimi horizontal dhe vertikal"*	NRP-02-7891-2026
23.	Vendim për lirimin nga pagesa e taksës komunale.	NRP-02-7894-2026
24.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: *"Furnizimi me pelet për nevojat e komunës së Rahovecit"*	NRP-02-7898-2026
25.	Vendim për preliminar mbi ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar.	NRP-02-7899-2026
26.	Vendim për fillimin e procesit për hartimin e Planit të Integritet.	NRP-02-7900-2026
27.	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit të Itegritetit të Komunës së Rahovecit për periudhën 2027-2029.	NRP-02-7902-2026
28.	Vendim për emërimin e kordinatorit të Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-7903-2026
29.	Vendim për caktimin e kordinatorit të Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit.	NRP-02-7904-2026
30.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: *"Ndërtimi I Sheshit Qendror të Qytetit-ritenderim-rregullimi estetik-faza përfundimtare"*	NRP-02-7907-2026
31.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve tekniketermave të referencës për aktivitetin e prokurimit : *"Grumbullimi i mbeturinave dhe mirëmbajtja e rrugëve gjatë dy sezonave"*	NRP-02-7913-2026
32.	Vendim për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve tekniketermave të referencës për aktivitetin e prokurimit *: "Rinovimi i palestrës sportive në ShML 'Xhelal Hjada-TON"*	NRP-02-7915-2026

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7832 Nr. i faq/Br.str/No.pg 86
Data/Datum/Date 1 / 9 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023")*, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/2025")* nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për caktimin e ushtruesit të detyrës

1. Artan Asllani, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, **CAKTOHET** ushtrues detyre i Udhëheqësit të Sektorit për regjistrimin e bizneseve në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, nga data 1.9.2026 deri me datë 31.8.2027.

2. Kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve janë të përcaktuara me Statutin e Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit me nr. prot. 01 Nr. 102/26, e datës 25.2.2026.

3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi do t'i takojë kompensimi i pagës sipas koeficientit të udhëheqësit të sektorit.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se pozita e udhëheqësit të Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e lirë (vakante), si dhe duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve dhe detyrave, të cilat dalin nga ky vend i punës, është i domosdoshëm caktimi i ushtruesit të detyrës së Udhëheqësit të Sektorit për regjistrimin e bizneseve në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Andaj, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Artan Asllani, i sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Zyrtar për Regjistrimin e Bizneseve në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, caktohet ushtrues detyre i Udhëheqësit të Sektorit për Regjistrimin e Bizneseve nga data 1.9.2026 deri më 31.8.2027.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Artan Asllanit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Njësisë së Personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7840 Nr. i faq/Br.str/No.pg 86
Data/Datum/Date 3 / 9 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 28 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 19 paragrafi 19.16 i Rregullores Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore"

1. Kosovare Gashi, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtare për Blegtori, Bletari dhe Veterinari në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, **emërohet** person përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore".

2. Personi përgjegjës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka për detyrë që të bëjë hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe Rregulloren Nr. 002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Përgjegjësitë e personit për hartimin e specifikimeve teknike / termave të referencës, janë:

   3.1. Në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë, në përputhje me nenin 28 Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe akteve nënligjore (legjislacionit dytësor);

   3.2. Në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë;

   3.3. Të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, një procesi të hollësishëm, ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë, ose ndonjë prodhimi.

4. Personi përgjegjës obligohet që të hartojë specifikimet teknike / termat e referencës deri më datë 9.9.2026.

5. Personi përgjegjës obligohet që, së bashku me specifikimet teknike / termat e referencës, të dorëzojë edhe deklaratën në betim, të nënshkruar te Njësia e Prokurimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Kosovare Gashi,***
- ***Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,***
- ***Njësia e Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7841 Nr. i faq/Br.str/No.pg 87
Data/Datum/Date 3 / 9 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Rinovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve", me nr. prokurimi: 623-26-6414-5-2-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-029-5-2-1, të datës 24.8.2026, në këtë përbërje:

   1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
   1.2. Vjollca Berisha, anëtare,
   1.3. Faik Thaqi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Rinovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve", me nr. prokurimi: 623-26-6414-5-2-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-029-5-2-1, të datës 24.8.2026.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. prot. 02/7802, i datës 25.8.2026.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVEC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC / ORAHOVAC

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7842 Nr. i faq/Br.str/No.pg 87
Data/Datum/Date 3 / 9 / 2026
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011")*, Rregullores (QRK) Nr. 19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimdhënësve, bashkëpuntorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (lEAA) të arsimit parauniversitar dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe kërkesës së Arbnore Sokolit nga Rahoveci, me nr. prot. 3346, të datës 2.9.2026, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lirim nga pozita e emërimit të përkohshëm të drejtorit të ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec

1. Arbnore Sokoli nga Rahoveci e emëruar përkohësisht në pozitën e drejtorit të ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, **LIROHET** nga kjo pozitë nga data 3.9.2026.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Më datë 12.6.2026, Arbnore Sokoli nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: Mësimdhënëse e edukatës fizike dhe shëndetësore në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, është emëruar përkohësisht drejtoreshë në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec.

Më datë 2.9.2026, e lartpërmendura ka parashtruar kërkesë për lirim të pozitës së drejtoreshës në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, për shkak të problemeve shëndetësore të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e kësaj pozite.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:
- ***Arbnore Sokoli,***
- ***Drejtoria për Arsim,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***NJMBNJ, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
ZYRA E KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7847 Nr. i faq/Br.str/No.pg 87
Data/Datum/Date 04/09/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011")* dhe nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, me Nr. Prot. 01 Nr. 1092, e datës 27.3.2015 Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim Adelina Shabandula, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zëvendësdrejtoreshë në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec **AUTORIZOHET** që të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme në ushtrimin e pozitës së Drejtorit të ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe zgjedhjes së drejtorit në këtë shkollë, sipas konkursit.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset e lartpërmendura në pikën 1 të këtij vendimi dhe Drejtoria për Arsim.

3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh, se pozita drejtorit në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, është e lirë, si dhe duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve si dhe detyrave të cilat dalin nga ky vend i punës, është e domosdoshme caktimi i Adelina Shabandula, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zëvendësdrejtoreshë në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe zgjedhjes së Drejtorit të ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, sipas konkursit.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa në kuadër të komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:
- ***Adelina Shabandula,***
- ***Drejtorisë për Arsim,***
- ***Njësisë së Personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7848 Nr. i faq/Br.str/No.pg 87
Data/Datum/Date 04/09/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkolla", me nr. prokurimi: 623-26-6821-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-030-1-2-1 të datës 03.09.2026, në këtë përbërje:

   1.1. Jeton Krasniqi, kryesues,
   1.2. Anduena Dula, anëtare,
   1.3. Nazlishahe Canziba, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizimi dhe rregullimi i xhamave në shkolla", me nr. prokurimi: 623-26-6821-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm: 623-26-030-1-2-1 të datës 03.09.2026.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7852 Nr. i faq/Br.str/No.pg 88
Data/Datum/Date 07 09 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, lidhur me nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023")*, neni 2 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 11 paragrafi 1, 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, kërkesës së Laureta Behlulit me nr. prot. 3017, të datës 10.8.2026 dhe pëlqimit të Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për transferimin e përhershëm të nëpunësit të shërbimit publik

1. **Miratohet** pjesërisht e bazuar kërkesa e Laureta Behlulit nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mësimdhënëse e lëndës së muzikës në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, për transferimin e përhershëm në interes të institucionit të ShUM "Faik Sylka" në Rahovec.

2. E lartpërmendura në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohet në ShUM "Faik Sylka" në Rahovec, në lëndën e pianos, me 10 (dhjetë) orë mësimore, ndërsa 10 (dhjetë) orë mësimore në lëndën e muzikës në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec.

3. Transferimi i nëpunëses së lartpërmendur bëhet me pëlqimin e saj dhe me pajtimin e udhëheqësit të drejtpërdrejtë, në kategori të njëjtë dhe në pagë të njëjtë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Laureta Behluli nga Rahoveci, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mësimdhënëse e lëndës së muzikës në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec, ka parashtruar kërkesë me nr. prot. 3017, të datës 10.8.2026, për transferim të përhershëm në ShUM "Faik Sylka" në Rahovec.

Kërkesa e të lartpërmendurës është miratuar pjesërisht, ku drejtori i Drejtorisë për Arsim, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë është pajtuar që e njëjta të transferohet në ShUM "Faik Sylka" në Rahovec, respektivisht të mbajë 10 (dhjetë) orë mësimore lëndën e pianos në këtë shkollë dhe njëkohësisht të mbajë 10 (dhjetë) orë mësimore në lëndën e muzikës në ShFMU "Isa Boletini" në Rahovec.

Ky transferim bëhet për interes të institucionit, pasi znj. Laureta Behluli i plotëson të gjitha kriteret për ushtrimin e kësaj pozite dhe transferimi bëhet me pëlqimin e saj dhe në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, ashtu siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për transferimin e nëpunësve civilë.

Nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- ***Laureta Behluli nga Rahoveci,***
- ***Drejtorisë për Arsim,***
- ***Njësisë së Personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7854 Nr. i faq/Br.str/No.pg 88
Data/Datum/Date 08 / 09 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0032357/26 dt. 02.09.2026 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[redacted] nga Rahoveci me datë 02.09.2026 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 27.08.2026 ka lindur **Vajzë** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë pë[redacted] dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim [redacted] njoftohen:

- [redacted]*ga Rahoveci,*
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7861 Nr. i faq/Br.str/No.pg 89
Data/Datum/Date 09/09/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, nenit 69 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Shitja e aseteve jashtë funksionit", me nr. të prokurimit: 623-26-6953-2-6-10 dhe me nr. të brendshëm: 001/2026 të datës 08.09.2026, në këtë përbërje:

   1.1. Egzon Thaqi, kryesues,
   1.2. Enise Dine, anëtare,
   1.3. Veton Kabashi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin: "Shitja e aseteve jashtë funksionit", me nr. të prokurimit: 623-26-6953-2-6-10 dhe me nr. të brendshëm: 001/2026 të datës 08.09.2026.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVEC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna Rahovec
OpštinaOrahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7862 Nr. i faq/Br.str/No.pg 89
Data/Datum/Date 09/09/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe kërkesës së ShFMU "Haki Stërmilli" në Zaqishtë e datës 28.08.2026, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e Drejtorit të ShFMU "Haki Stërmilli" në Zaqishtë dhe i ndahen 100 (njëqind) litra derivate, për mbulimin e shpenzimeve të transportit të nxënësve nga fshati Zoqishti në objektin e kësaj shkolle në fshatin Retijë dhe ansjelltas.

2. Automjeti transportues i cili do të bëj bartjen e nxënësve në relacionin e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është: Tipi – MERCEDEZ BENZ 312D; Targa – 07-924-EN; Numri i ulësve – 14; Ngjyra – E BARDH.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se në objektin e ShFMU "Haki Stërmilli" në Zaqishtë janë duke u bërë punime për renovimin e objektit të kësaj shkolle dhe me këtë rast është e pamundur zhvillimi i procesit mësimor në këtë objekt, drejtori i ShFMU "Haki Stërmilli" në Zaqishtë ka parashtruar kërkesë në Drejtorinë për Arsim për mbulimin e shpenzimeve të transportit të nxënësve të kësaj shkolle nga objekti i shkollës në Zoqisht, objektin e kësaj shkolle në fshatin Retijë dhe anasjelltas.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkese nga drejtoria, e njëjta ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ mbulimin e shpenzimeve të derivateve për bartjen e nxënësve në objektin e ShFMU "Haki Stërmilli" në fshatin Retijë ku nxënësit do të vijojnë mësimin deri në përfundim të punimeve në objektin e kësaj shkolle në fshatin Zoqisht.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- ***Drejtorisë për Arsim,***
- ***Drejtorit të ShFMU "Haki Stërmilli" në Zaqishtë,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVEC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA ORAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7865 Nr. i faq/Br.str/No.pg 89
Data/Datum/Date 10/09/26

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 44, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 dhe nenit 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të datës 25.05.2016 dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Shfuqizohet** Urdhëresa me Nr. Prot. 02/7790 e datës 21.8.2026 për shpalljen e tenderit me titull: "Servisimi i pajisjeve mjekësore", në vlerën e parashikuar prej 90,000.00€ (nëntëdhjetë mijë euro).

2. **Shfuqizohet** Vendimi me Nr. Prot. 02/7791 i datës 21.8.2026 për emërimin e personit përgjegjës për hartimin e specifikave teknike / termave të referencës për aktivitetin e prokurimit "Servisimi i pajisjeve mjekësore".

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit

Me vendim të njoftohen:
- ***Zyra e Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7867 Nr. i faq/Br.str/No.pg 89
Data/Datum/Date 11/09/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M
Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Furnizim me pajisje të teknologjisë informative në bazë të kontratës së AQP-së", me numër të kontratës: 623-26-6500-5-5-8/C731, si në vijim:

1.1. Dritan Sokoli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës: Zyrtar i teknologjisë informative në Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2. Afrim Dina, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit te Menaxheri i Kontratës.

3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

4.2. Menaxheri i kontratës, duhet te lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;

4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;

4.4. Pas pranimit te urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;

4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;

4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;

4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.12. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;

4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;

4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe

4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe

5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

Zyrtar Kryesor Administrativ

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7873 Nr. i faq/Br.str/No.pg 90
Data/Datum/Date 14/09/26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023")*, nenit 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së Shqipe Morina me Nr. Prot. 3413 të datës 09.09.2026, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M
Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e Shqipe Morinës nga fshati Ratkoc, komuna e Rahovecit, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mësimdhënëse e lëndës biologji - kimi në ShFMU "Skender Kastrati" në Radoste (Malësi e Vogël), nga data 1.10.2026 deri më datë 30.9.2027.

2. Të lartpërmendurës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme, pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Obligohet zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largojë nga lista e pagës të lartpërmendurën për periudhën sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Shqipe Morina nga fshati Ratkoc, e sistemuar në punë dhe në detyrat e punës: mësimdhënëse e lëndës biologji - kimi në ShFMU "Skender Kastrati" në Radoste, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 3413, të datës 9.9.2026, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë nga data 1.10.2026 deri më datë 30.9.2027.

Kërkesën e lartpërmendura e ka parashtruar për arsye shëndetësore dhe familjare.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme, pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë

e zyrtarëve publikë, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtarja publike ta shfrytëzojë pushimin pa pagesë.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në Komisionin për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Komunës së Rahovecit.

Me vendim të njoftohen:

- ***Shqipe Morina nga fshati Ratkoc,***
- ***Drejtoria për Arsim,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrtari/ja për paga,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7876 Nr. i faq/Br.str/No.pg 90
Data/Datum/Date 17 / 09 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M
Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Rinovimet dhe riparimet e objekteve të QMF-ve dhe AMF-ve", me numër të kontratës: 623-26-6414-5-2-1/C733, si në vijim:

   1.1. N.P.N. "UNIVERS – MI"; "P.M.N." SH.P.K., me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Bardhok Jetishi, **CAKTOHET** menaxher i kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2. Afrim Oruqi, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit te Menaxheri i Kontratës.

3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
   3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë;
   3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë; dhe
   3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.

4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
   4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në

Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

4.2. Menaxheri i kontratës, duhet te lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;

4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblerjen;

4.4. Pas pranimit te urdhërblerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;

4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;

4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;

4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;

